



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:088714
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05751282

PN.II.nr.4/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Mejreme Memaj kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit E. S., për shkak të veprës penale shtytje në kryerjen e vrasjes së rëndë nga neni 147 par. 3 dhe 9 lidhur me nenin 24 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), duke vendosur lidhur me ankesën e mbrojtësit të të pandehurit, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.S.nr.91/2024 të datës 17.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me 27.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të pandehurit E. S., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.S.nr.91/2024 të datës 17.05.2024.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda me aktvendimin PKR.nr.170/2020 të datës 03.05.2024, të pandehurit E. S., për shkak të veprës penale shtytje në kryerjen e vrasjes së rëndë nga neni 147 par. 3 dhe 9 lidhur me nenin 24 të KPPK, ia ka ndërprerë masën e arrestit shtëpiak me datën 03.05.2024 dhe e ka liruar që të mbrohet në liri, konform nenit 181 par. 7 lidhur me nenin 190 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN.1.S.nr.91/2024 të datës 17.05.2024, e ka aprovuar ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe e ka ndryshuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, ashtu që të pandehurit i ka caktuar

masën e paraburgimit, konform dispozitës së nenit 184 par. 1 nën par.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1 e lidhur me nën par. 1.3 të KPP, e cila masë do t'i zgjasë deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar me aktgjykim.

Kundër këtij aktvendimi, në afat ligjor, ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të pandehurit E. S. av. Besnik Berisha, për shkak të shkeljes së të drejtës për liri dhe siguri, të garantuar nga neni 29.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, shkeljes esenciale të neneve 7, 159, 172.2, 182.2, 184.1, 188.1 dhe 366.1 të KPP, si dispozita procedurale të cilat garantojnë zbatimin efektiv dhe përmbajtësore të së drejtës nga neni 29.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të konstatojë se aktvendimi i atakuar përmban shkelje esenciale të neneve 7, 159, 171.2, 182.2, 184.1 dhe 366.1 të KPP, çka ka rezultuar gjithashtu në shkelje të së drejtës kushtetuese për liri dhe siguri, të garantuara nga neni 29.1 dhe 29.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ta aprovojë si të bazuar ankesë e mbrojtjes, të anulojë aktvendimin PNI.S.nr.91/2024 të datës 17.05.2024 dhe të vërtetojë aktvendimin PKR.nr.170/2024 të datës 03.05.2024 ose të ndryshojë aktvendimin e Gjykatës së Apelit dhe të caktojë masën e arrestit shtëpiak nga neni 181 të KPP si alternativë më e butë për të neutralizuar rreziqet përkatëse nga neni 184 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.1 të KPP.

Kryeprokurori i Shteti, me parashtresën PPAIII.nr.02/2024 datë 23.05.2024, propozon që ankesa e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pabazë.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Mbrojtësi i të pandehurit në ankesën e tij ka theksuar se ankesa e PSRK e datës 08.05.2024, në mënyrën siç është parashtruar ishte ligjërish e ndaluar sepse nuk ka mbështetje ligjore dhe të njëjtës në tërësi i mungojnë kërkesat ligjore imperative nga neni 376 nën par. 1.5 dhe 1.6 të KPP, dhe se ankesa përveç se ishte e palejuar për shkak të përshtatshmërisë ligjore me neni 411 të KPP, njëkohësisht ka rënduar kundërligjshëm pozitën e të pandehurit në këtë stad të procedurës penale, pasi që gjykata e shkallës së parë përmes aktvendimit të ankimit ka ndërprerë masën e arrestit shtëpiak në mënyrë të ligjshme dhe në stadin e lejuar procedural. Arsyetimi i aktvendimit PNI.S.nr.91/2024 është vetëm formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi që nuk ka trajtim të pretendimeve të mbrojtjes. Sipas praktikës së GJEDNJ është theksuar se ndonëse ekzistimi i dyshimit të bazuar se personi ka kryer veprën penale është parakusht për paraburgimin, ai nuk mjafton si arsye e vetme për ndalimin pas një kohe të caktuar, pavarësisht se sa e rëndë është vepra dhe forca provuese e provave kundër të pandehurit.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme ankimore të mbrojtësit janë të pabazuara, sepse ankesa nuk është e kundërligjshme por është e drejtë dhe e ligjshme (siç me të drejtë janë

udhëzuar palët për të drejtën e ankesës në aktvendimin e shkallës së parë) si dhe kategori kushtetuese, po ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë, duke vepruar sipas ankesës ka të drejtën dhe kompetencën që konform gjetjeve të ndryshojë (si në rastin konkret) vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së dytë drejtë ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, në vendimin e sajë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me peshën dhe mos përshtatshmërinë e mos vazhdimit të masës së arrestit shtëpiak duke e liruar të njëjtin që të mbrohet në liri pas shpalljes së aktgjyimit, dhe se nuk ka vepruar drejtë kur ndaj të pandehurit është caktuar mbrojtja në liri, kur të merret parasysh fakti se i pandehuri është akuzuar për veprë të rëndë penale dhe se për të njëjtin veprë është shpallur fajtorë dhe është dënuar me 25 vite burgim. Lartësia e dënimit të shqiptuar paraqet rrethana që e bën të arsyeshme drojën për rrezikun e arratisjes së të pandehurit.

Kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për caktimin e masës së paraburgimit konform nenit 184 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.1 të KPP, duke pasur parasysh lartësinë e dënimit të shqiptuar, është rrethanë e cila tregon rrezikun se me lëniën në liri të të pandehurit ekziston mundësia që i njëjti të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke u arratisur, ikur apo fshehur për t'iu shmangur përgjegjësisë penale, e në këtë mënyrë pamundësohet zhvillimi i rregullt i procedurës penale.

Duke pasur parasysh rrethanat e lartcekura, kjo gjykatë konsideron se masat tjera respektivisht mbrojtja në liri do të ishte e pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurën penale dhe se pretendimet ankimore të mbrojtësit nuk janë të bazuara. Edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, caktimi i paraburgimit si masë e sigurisë për praninë e tij në procedurë dhe përfundimin e papengesë të saj, është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 411 par. 8 lidhur me nenin 416 par.2 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PN.II.nr.4/2024 më 27.05.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit
Mejreme Memaj